

AKT THEMELEMI
i
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TECNAL” sh.p.k.

NENI 1

Sot më 20.1.2022, në bazë të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnetin e tij të lirë, zoti **GERONT SELENICA** i biri i Mustafa dhe Zenepe lindur në Tiranë më 20.05.1966 banues në Tiranë, Rr “Abdi Toptani”, Torre Drini, Nr 142, i identifikuar me letërnjoftim me numër personal G60520111K, aktualisht përdorues i telefonit 00355692040000, vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi, sipas kërkesave të ligjit, mbështetur në parimet e mëposhtëme:

NENI 2

Emërtimi

Shoqëria tregtare emërohet **“TECNAL” sh.p.k.** dhe me themelues dhe aksioner të vetëm zotin Geront Selenica.

NENI 3

Selia

Shoqëria e ka seline e saj në Tiranë, në Rr. “Abdi Toptani”, Torre Drini, apartamenti 132. Me miratim të organeve të saj kompetente ajo mund të ndryshojë selinë. Mund të hapë degë, filiale, përfaqësi e agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj.

NENI 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.



NENI 5

Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si mëposhtë:

- konsulencë inxhinierike, mjedisore, ekonomike, ligjore dhe politike për planifikime strategjike, hulumtime, studime fizibiliteti, projektme, modelime të informacioneve të ndërtimit (BIM), modelime numerike, simulime, analiza, zbatime e mbikëqyrje për realizimin e komplekseve industriale, civile e ushtarake, hidrocentraleve, infrastrukturës, superstrukturës e sigurisë së porteve, marinave, zhvillimeve bregdetare, strukturave bregdetare e detare, porteve të thata, qendrave logjistike, hekurudhave, rrugëve, urave, tuneleve e punimeve nëntokësore, të industrisë së naftës e gazit dhe të energjisë së rinovueshme;
- studime e shërbime gjeologjike, gjeoteknike, gjeodezike, sizmiologjike, hidrogjeologjike, hidroteknike, hidrografike, topografike, vrojtime ajrore, arkeologjike, vlerësime të ndikimit ne mjedis e social (ESIA);
- Ofrimin e shërbimeve të plota për projektim dhe ndërtim për infrastrukturën dixhitale, fibra optike e data center, dhe për software;
- Ofrimin e shërbimeve të plota për projektim dhe ndërtim për bujqësinë dhe industrinë përpunuese ushqimore;
- Ofrimin e shërbimeve arkitekturore, planifikim urban, strukturore, mjedisore, HVAC, hipotekore, përfitim lelesh;
- Ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror, detar e tokësor;
- Ofrimin e shërbimeve të plota të planifikimit dhe të zhvillimit të biznesit, menaxhimit të projekteve dhe programeve, zhvillimit të burimeve njerëzore, dizajn dhe zhvillim organizativ, shërbime financiare, modelim financiar, financim projektsh, analiza makroekonomike,
- Ofrimin e shërbimeve të plota juridike brenda e jashtë, PR, këshillime politike dhe të sigurisë fizike dhe kibernetike, shërbime logjistike, shërbime në fushën publicitare, të reklamave, të botimeve dhe medias;
- Realizimin e veprimeve tregtare për import-eksport e mallrave industrialë, ushqimorë dhe teknologjisë;
- Veprimtari ndërtimore për realizimin e komplekseve industriale, civile e ushtarake, hidrocentraleve, porteve, marinave, zhvillimeve bregdetare, strukturave bregdetare e detare, porteve të thata, qendrave logjistike, hekurudhave, rrugëve, urave, tuneleve e punimeve nëntokësore, të industrisë së naftës e gazit dhe te energjisë së rinovueshme.



NENI 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lek dhe përbëhet nga 1 kuotë, 100% me kontributin e ortakut.

Kapitali themeltar është tërësisht në para. Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer krejtësisht nga ortaku themelues.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 7

Administrator i shoqërisë "TECNAL" sh.p.k. është zoti Geront Selenica.

NENI 8

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar si dhe në bazë të Statutit dhe këtij Akti Themelimi.

NENI 9

Dispozita e fundit

Ky akt themelimi është përpiluar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKU

GERONT SELENICA

Geront Selenica
